I nderuar Famullitar i Kishës Shën Nënë Tereza në Dugajevë,
Don Ambroz Demaj,

Në një bisedë telefonike me anëtarin tonë të stafit organizativ, z. Marjan Gojani, kemi diskutuar edhe një herë nevojën për të pasur një bilanc të përgjithshëm të projektit, si në aspektin financiar, ashtu edhe në atë të punimeve të realizuara dhe atyre që kanë mbetur për t'u përfunduar.

Duke qenë se punimet në Kishë tashmë janë në fazën përfundimtare, dëshirojmë ta përsërisim edhe një herë, siç e kemi theksuar shumë herë deri më tani, se ka ardhur koha e duhur për të pasur një pasqyrë të qartë, të plotë dhe transparente të gjendjes së projektit.

Në veçanti, do të ishte e nevojshme të kemi një pasqyrë të:

- të hyrave nga donacionet në euro, dollarë amerikanë dhe franga zvicerane;
- krahasimit të tyre me të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Kishës;
- gjendjes së llogarisë bankare të Kishës Shën Nënë Tereza në Dugajevë dhe mjeteve financiare në dispozicion;
- obligimeve dhe borxheve të mbetura;
- shpenzimeve të realizuara deri më tani;
- punëve të përfunduara dhe atyre që ende kanë mbetur, së bashku me kostot e pritshme për përfundimin e tyre.

Dua të theksoj edhe një herë se qëllimi i kësaj kërkese nuk është krijimi i tensioneve, por një vlerësim i hapur, i qartë dhe konstruktiv i gjendjes aktuale, në mënyrë që së bashku ta çojmë projektin drejt përfundimit.

Do të jem në Kosovë nga data 3 deri më 6 shtator, së bashku me një delegacion nga Austria, dhe do të doja ta shfrytëzonim këtë mundësi për t'u takuar dhe për t'i diskutuar nga afër këto çështje.

Më datën 3 shtator do të jem i angazhuar me delegacionin, ndërsa më datat 4, 5 dhe 6 shtator jam i gatshëm ta përshtat orarin tim sipas mundësive tuaja.

Do ta vlerësoja shumë nëse do të më njoftonit më së largu deri të dielën, më 30.08.2026, për mundësinë, vendin dhe kohën e takimit, pasi pas kësaj date nuk do të kem më mundësi ta ndryshoj agjendën time gjatë vizitës në Kosovë.

Me respekt dhe mirënjohje,

Kolë Berisha

P.S.: Ju lutem, na njoftoni edhe për datën e përurimit të Kishës ose, nëse ende nuk është përcaktuar përfundimisht, për datën e përafërt, në mënyrë që të kemi mundësi t'i njoftojmë me kohë të gjithë, veçanërisht mysafirët ndërkombëtarë, në mënyrë që ata të kenë kohë të mjaftueshme për të planifikuar pjesëmarrjen e tyre.